

Rregullat Për përcaktimin e formatit të të dhënave dhe procedurën për aksesin e furnizuesve ndaj të dhënave të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike

Neni 1

Autoriteti

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 69, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” Ligjit nr. 9501 dt. 03/04/2006 “Për ratifikimin e Traktatit për krijimin e Komunitetit të Energjisë”.

Neni 2

Objekti

1.Kjo Rregullore përcakton tërësinë e rregullave mbi procedurat dhe kërkesat për informacion, lidhur me publikimin në kohë të të dhënave mbi konsumin e energjise elektrike në mënyre transparente dhe jo diskriminuese nga OSHEE.

2.Kjo Rregullore gjithashtu përcakton në mënyrë të detajuar detyrimet e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, në lidhje me vënien në dispozicion të të dhënave që lidhen me konsumin e energjisë elektrike nga klientët fundorë dhe çështjeve të tjera të nevojshme për publikimin e tyre.

Neni 3

Aksesi i të dhënave

1. OSHEE do të sigurojë si pjesë të Shërbimit të ofruar prej saj, aksesin në të dhënat e konsumit të energjisë elektrike nga Klientet.
2. Operatori do të sigurojë këtë shërbim nëpërmjet një faqeje interneti të dedikuar, por edhe nëpërmjet çdo qendër të kudjesit të klientit, ku Furnizuesi paraqitet me kërkesë për të dhëna. Historia e konsumit është në dispozicion përmes faqes së internetit apo nëpërmjet dokumentit të vënë në dispozicion nga Zyrat e Klientit apo edhe çdo formë tjetër të dërgimit të të dhënave, përfshirë por pa u kufizuar, përmes mesazheve telefonike e forma të tjera të arritshme nga publiku.
3. Informacioni historik (që përfshin konsumi vjetor për jo më pak se një periudhë që përfshin tre vitet e fundit, është një e drejtë e garantuar për të gjithë furnizuesit nga legjislacioni. Për më tepër, të dhënat mbi baza mujore e informacionit sigurohen nga OSSH tek Furnizuesi.
4. OSSH i siguron furnizuesit edhe të dhënat e energjisë elektrike mbi baza orare për të gjithë klientët kur pajisjet e matjes e lejojnë një përllogaritje të tillë.
5. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe Operatori duhet të dorëzojnë tek Furnizuesi të dhënat e kërkuara sipas kësaj rregullore jo më vonë se 1 (një) ditë kalendarike pas marrjes së kërkesës nga një Furnizues.
6. Furnizuesi që kërkon të dhënat si më sipër, duhet që më parë të ketë nënshkruar një marrëveshje nëpërmjet të cilës garanton për të përmbushur detyrimet e legjislacionit në fuqi, duke përfshirë, në veçanti, legjislacionin mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Neni 4

Detyrime te tjera

1. OSHEE do të krijojë kode që përcaktojnë rregullat për përdorimin dhe hyrjen në të dhënat e përcaktuara sipas kësaj rregullore.

Rregullat Për përcaktimin e formatit të të dhënave dhe procedurën për aksesin e furnizuesve ndaj të dhënave të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike

2. Furnizuesi nuk ka akses të drejtpërdrejtë në programet e aksesit, por do të ketë akses në të dhënat e konsumit të energjisë elektrike nga OSHEE duke përdorur një portal të përbashkët për të gjithë furnizuesit.
3. Në çdo, rast ky portal do të sigurojë Identifikimin individual elektronik, të cilit i përkon një kod unik që do të gjenerohet për çdo furnizues të rregjistruar, e që ka një kontratë me OSHEE.
4. Për të gjitha rastet kur kërkohet nga Furnizuesi, OSHEE do të ofrojë të dhëna sipas Formatit mbi baza orë, mujore, tremujore dhe vjetore.
5. Informacioni mbi këto të dhëna përditësohet maksimumi pesë ditë(kalendarike) pas ditës së konsumit /të fundit të rregjistruar, kur paisjet e matjes lejojnë matjet orare
6. Në çdo rast tjetër, përditësimi i të dhënave do i korrespondojë muajit të fundit të rregjistruar me matje.

Neni 5
Interpretimi

Në rast se një çështje nuk është trajtuar në këtë rregullore, ERE do të vendosë rast pas rasti dhe do të nxjerrë udhëzimet sipas kërkesave përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 6
Amendime të rregullores

Këto rregulla janë objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të ERE, si dhe në përputhje me rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s.

Neni 7
Hyrja në fuqi

- 1.Kjo Rregullore “Për përcaktimin e formatit të të dhënave dhe procedurën për aksesin e furnizuesve ndaj të dhënave të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike hyn ne fuqi, jo më vonë se 12 muaj nga miratimi i këtyre Rregullave nga ERE.
2. Deri në hyrjen në fuqi të këtyre rregullave, në çdo rast Oshee do të sigurojë këtë akses te Furnizesit sipas formave të tjera të parashikuara në këte rregullore.

Rregullat Për përcaktimin e formatit të të dhënave dhe procedurën për aksesin e furnizuesve ndaj të dhënave të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike

ANEKSI

FORMATI I TË DHËNA

NR.KODI UNIK I KËRKESËS	
KËRKUESI	
DATA E RREGJISTRIMIT TË KËRKESËS	
KODI I KONSUMATORIT OBJEKT I KËRKESËS NGA FURNIZUESI	
TË DHËNA MBI KONSUMIN VJETOR/DITOR /MUJOR/ORAR SIPAS KËRKESËS	
NËSE NUK SPECIFIKOHET NË KËRKESË, TË DHËNAT DO TË PËRFSHIJNË KONSUMIN VJETOR TË 3 VITEVE TË FUNDIT	
AFATI I TRAJTIMIT	
DETYRIMI PËR TRAJTIMIN E TË DHËNAVE SIPAS KËRKESAVE TË LIGJIT “PËR MBROJTEN E TË DHËNAVE PERSONALE”	